

**LIGJ**  
**Nr.8387, datë 30.7.1998**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7952, DATË 21.6.1995 "PËR SISTEMIN ARSIMOR  
PARAUNIVERSITAR"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

**KUVENDI POPULLOR**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Në ligjin nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar" në të gjitha nenet fjalët "Ministria e Arsimit" ndryshohen dhe bëhen "Ministria e Arsimit dhe e Shkencës".

Neni 2

Në nenin 13 shtohet një paragraf i dytë me këtë përmbajtje:  
"Ministria e Arsimit dhe e Shkencës përcakton kriteret për dhënien e Medaljes së Artë nxënësve që përfundojnë arsimin e mesëm publik apo privat me rezultate të shkëlqyera."

Neni 3

Në nenin 25 shtohet paragrafi 25.3 me këtë përmbajtje:  
"Institucioni arsimor, ku duhet të regjistrohet fëmija përcaktohet nga organet e pushtetit lokal, me propozim të drejtorisë arsimore të rrethit".

Neni 4

Në nenin 43 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:  
"Ndër institucionet arsimore, publike, parauniversitare mund të privatizohen vetëm institucionet e arsimit profesional. Në këto raste mjediset, pajisjet dhe trualli i tyre privatizohen në përputhje me dispozitat në fuqi.  
Ndalohet ndryshimi i destinacionit të institucionit arsimor publik të arsimit profesional të privatizuar."

Neni 5

Në nenin 44 në pikën 44.1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:  
"Ministria e Arsimit dhe e Shkencës propozon institucionin arsimor publik të arsimit profesional, i cili do të privatizohet. Miratimi bëhet nga Këshilli i Ministrave me vendim të veçantë. Mënyrat dhe fazat e procesit të privatizimit përcaktohen nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe e Privatizimit dhe nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës."

Neni 6

Në nenin 44, në pikën 44.4, fjalia e fundit ndryshohet si vijon:  
"Leja për hapjen e institucioneve arsimore private nuk mund të jepet me parë se 3 muaj dhe jo më vonë se 1 vit nga koha e depozitimit të kërkesës."

## Neni 7

Pas nenit 44 shtohet neni 44/a, me këtë përmbajtje:

"44/a.1. Krahas institucioneve arsimore private të niveleve të arsimit parauniversitar, lejohen hapja dhe funksionimi i institucioneve arsimore, private, plotësuese. Quhen të tilla ato institucione arsimore e njësi shkollimi që funksionojnë jashtë strukturave të institucioneve arsimore, publike e private dhe ku punohet në drejtim të arsimit e të edukimit në lëndë e specialitete të veçanta, brenda ose jashtë planeve mësimore, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

44/a.2. Leja për funksionimin e institucioneve arsimore, private, plotësuese jepet nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës jo më parë se dy muaj nga data e depozitimit të kërkesës.

44/a.3. Kriteret për hapjen dhe funksionimin e tyre përcaktohen me akte nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës."

## Neni 8

Neni 59 ndryshohet si vijon:

"Kur nxënësit e moshës 6 deri 16 vjeç, të cilët i përfshin detyrimi shkollor, mungojnë pa arsye në shkollë ose e braktisin atë, prindërit e tyre dënohen për kundërvajtje administrative me gjobë nga 1 000 deri në 10 000 lekë, si vijon:

59.1 Kur nxënësi mungon në mësim pa arsye 30-50 për qind të kohës në 2 muaj të njëpasnjëshëm, masa e gjobës është 1 000 deri 3 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje gjatë po atij viti, gjoba bëhet 5 000 lekë.

59.2 Kur nxënësi mungon pa arsye mbi 50 për qind të kohës në 2 muaj të njëpasnjëshëm, masa e gjobës është 5 000 deri në 7 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje gjatë po atij viti ose braktisjeje të shkollës, gjoba bëhet 10 000 lekë.

59.3 Vendimi i gjobës jepet nga kryetari i bashkisë apo i komunës, sipas propozimit të drejtorit të shkollës.

Kundër vendimit të gjobitjes mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes së njoftimit në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja.

59.4 Përrjashtohen nga gjoba ata prindër, fëmijët e të cilëve janë regjistruar në një shkollë, shqiptare a të huaj, brenda vendit, me kusht që të paraqesin dokumentin e regjistrimit pranë drejtorisë së shkollës në vendbanimin e tyre.

59.5 Përrjashtohen nga gjoba ata prindër, fëmijët e të cilëve janë regjistruar në një shkollë jashtë vendit."

## Neni 9

Paragrafi i parë i nenit 61 ndryshohet si vijon:

"Hapja e institucioneve arsimore private dhe e institucioneve arsimore private plotësuese në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji përbën kundërvajtje administrative. Kundërvajtësit në çdo rast, dënohen me gjobë, përkatësisht 500 000 lekë dhe 200 000 lekë, si dhe me ndërprerje të veprimtarisë së filluar."

## Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2178, datë 3.8.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**